



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.352/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret; Hajriz Hoti, kryesues, Violeta Husaj-Rugova, Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e Subjektit Politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, të parashtruara kundër Subjektit Politik, Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë;06.02.2025, merr këtë,

V E N D I M

I. Pranohen si të bazuara ankesat e Subjektit Politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, Anr.352/2025, Anr.354/2025, Anr.355/2025 dhe Anr.356/2025 të datës;04.02.2025.

II. Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 15.000.00 € (Pesëmbëdhjetë mijë) Euro.

III. Detyrohet Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë;04.02.2025, PZAP-i ka pranuar ankesat nga Subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, Anr.352/2025, Anr.354/2025, Anr.355/2025 dhe Anr.356/2025.

Në ankesën Anr.352/2025, pretendohet se më datë 03 shkurt 2025, në profilin e mbështetësit, simpatizantit dhe aktivistit të Lëvizjes Vetëvendosje, me emrin në rrjetin social Facebook "Albin Forca", ka publikuar disa video me tekst shoqërues, në të cilën shkruan "PDK, MOS BËNI FUSHATË ME FAMILJEN JASHARI. Parti më të poshtër sesa PDK nuk dijnë që ka në Kosovë. Po tentojnë të fitojnë vota me këngën e Adem Jasharit, ndërsa kreu i partisë, e shumë deputetë të saj nuk shkojnë në Kullën e Adem Jasharit, bashkë me këngëtaren Shkurte Fejza e cila përfundoj familjarisht në grupin e gangsterëve, siç i quante ajo në vitin 2018 banditët që e drejtonin shtetin. TURP PDK". Ky postim deri në momentin e parashtrimit të kësaj ankese është shpërndarë (share) plotë 50 herë nga profile në rrjetin social Facebook dhe i është nënshtruar një publiciteti të madh.

Në ankesën Anr.354/2025, pretendohet se më datë 02 shkurt 2025, në profilin e mbështetësit, simpatizantit dhe aktivistit të Lëvizjes Vetëvendosje, në rrjetin social Facebook me emrin "Albin Forca", ka publikuar një video me tekst shoqërues, në të cilën shkruan "TRADHTIA NDAJ KOSOVËS ME FAKTE. Vlora Çitaku, tradhtinë tuaj ndaj Kosovës nuk mund ta fshehësh. Sabina Cudic të ka kërkuar debat, ndërsa ti nuk pate guximin të ballafaqohesh me faktin e saj. Ti je vetëm një mashtruese, sepse me para të taksapaguesve ke lobuar për ndarjen e Kosovës. TURPI KA EMËR, ajo është Vlora Citaku. Dëgjoje videon dhe më kontakto, sepse kam material dhe Pyetje edhe unë për ty. VOTUESIT NUK I VOTOJNË TRADHËTARËT. Tradhtari e voton tradhtarin. Më tej theksohet se ky postim deri momentin e parashtrimit të kësaj ankese është shpërndarë (share) plotë 109 herë nga profile në rrjetin social Facebook dhe i është nënshtruar një publiciteti të madh.

Në ankesën Anr.355/2025, pretendohet se më datë 03 shkurt 2025, mbështetësi i Lëvizjes Vetëvendosje, z. Reshat Krasniqi, i ka dërguar mesazh sekretares së Partisë Demokratike të Kosovës, znj. Vlora Citaku, në të cilën shkruan: "Nanen Drenica ta qift. U plake tu marr me halle të Drenicës në vend me gjet veten dikun ti mundohesh me jetu e mbijetu nga politika e nga Drenica".

Në ankesën Anr.356/2025, pretendohet se më datë 03 shkurt 2025, mbështetësi i hapur i Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje, z. Halil Geci, ka publikuar një fotografi në rrjetin social Facebook, me tekst shoqërues, në të cilën shkruan "VOTA E JUAJ ËSHTË MBROJTJA E KOSOVËS! 9 SHKURT ËSHTË DITA KUR DO TI PËMBYESMI TRADHËT E BRENDSHËM DHE TË JASHTËM DHE DO TË GODASIM NDËRHRYJET E HUAJA.... Propaganda e intensifikuar nga këto portale, si dhe nga përfaqësues të partive opozitare PDK dhe LDK, të cilët shpesh përputhen në qëndrime me interesat serbe dhe ruse tregon qartë angazhimin e tyre për të zbatuar marrëveshje që rrezikojnë sovranitetin dhe integritetin e shtetit tone. Sipas parashtruesit të ankesës ky postim deri në momentin e parashtrimit të kësaj ankese është shpërndarë (share) plotë 184 herë nga profile në rrjetin social Facebook dhe i është nënshtruar një publiciteti të madh. Me këto veprime sipas parashtruesit te ankesave është bërë shkelje e rëndë e Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, respektivisht nenit 34, paragrafi 1, nën paragrafi 1.11. Provë: CD me përmbajtje të video incizimit të fjalimit në tubimin e mbajtur nga Lëvizja Vetëvendosje në Komunën e Gjilanit, në të cilën nga minuta 00:50 e deri në përfundim të video incizimit, -Postimi i publikuar nga mbështetësi i Lëvizjes Vetëvendosje, në profilin me emër Albin Forca, në rrjetin social Facebook-[https://www.facebook.com/61562178526650/videos/1025883025962838;](https://www.facebook.com/story.php?story_fbid=1033901418776108&id=100064687781495&mibextid=eyJlfr&rdid=csFacDgUQBarëvmL#:-https://www.facebook.com/61562178526650/videos/1025883025962838;) -Provë: Postimi i publikuar nga mbështetësi i Lëvizjes Vetëvendosje, z. Halil Geci, në rrjetin social Facebook <https://www.facebook.com/halil.geci/posts/pfbid02QrS3i67eNheue46VgEZern8fZGpeZoKZfZYChEb7VHyXtDxMVë38uAi90Vx9Jxpnl>; Provë: Mesazhi në rrjetin social Facebook, dërguar nga z. Reshat Krasniqi për znj. Vlora Citaku, më datë 03 shkurt 2025:

Në përgjigjet në ankesë theksohet se nga provat e bashkangjitura, rezulton se subjekti i cili nga ankuesi kategorizohet si mbështetës nuk mund të identifikohet, pasi që ky profil nuk përdoret nga ndonjë person konkret (ashtu siç profilet në facebook rëndom hapen), mirëpo është një keqpërdorim i Llogarisë nga ky person fiktiv "Albin Forca" për të cilin ne është e panjohur se kush fshehët prapa tij. Është e pamundur lidhja mes subjektit LVV dhe një personi fiktiv, për arsye se ligji nuk njeh si mbështetës personat fiktiv, por personat konkret të cilët faktohen me emër dhe mbiemër. Më tej në përgjigjet në ankesë theksohet se nuk mund të vërtetohet përgjegjësia Objektive dhe jo ajo Subjektive, përgjegjësinë në këto raste për mbështetësit e subjekteve politike. Dhe në pretendimet ankimore se një person me emrin Reshat Krasniqi të cilin pala ankuese e konsideron si mbështetës të subjektit politik LVV, i cili ka fyer kandidaten për deputete të Partisë Demokratike përmes dërgimit të mesazheve private në platformën Messenger, në asnjë rrethanë nuk mund të provohet fakti se mesazhet private të dërguara në drejtim të znj Çitaku janë dërguar nga një mbështetës i subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje! Nga observim i thjeshtë i profilit persona në Facebook vërehet se personi i lartcekur nuk mbështet as Lëvizjen Vetëvendosje as ndonjë kandidat të saj për deputet. Si dhe lidhur me pretendimet ankimore se z. Geci si mbështetës të LVV ka bërë shkeljen e pretenduar, konsiderojnë se në asnjë moment, nuk përmban ndonjë fakt dhe provë të cilat do ta ndërlidhnin, përfshirë ndërlidhjen e shkeljes së pretenduar e cila sipas tyre, do të binte ndesh me nenin 34 paragrafi 1, nën paragrafi 1.11 të LZP-së.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimin dhe Vendosies së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat Anr.352/2025, Anr.354/2025, Anr.355/2025 dhe Anr.356/2025 të paraqitura me datë 04.02.2025, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjë e përbashkët A.nr.350/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesit.

Paneli pasi vlerësoi ankesat dhe përgjigjet në ankesa, vëren se ankesat janë të bazuara.

Paneli, pas shikimit të shkresave të lëndës të ofruar si provë materiale, dhe postimet në facebook, vlerëson se përdorimi i kësaj gjuhe nga simpatizantët e subjektit politik të LVV-së, Reshat Krasniqi Halil Geci, dhe Albin Forca të postuar në rrjetin social facebook me emrin "Albin Forca", në kuadër të fushatës zgjedhore, konsiderohet shkelje e rregullave zgjedhore në Kosovë, ngase veprimi i marrë në kohë të fushatës zgjedhore ka për qëllim të krijojë një lidhje negative ose të nxisë ndjenja të urrejtjes dhe krijoj atmosferë tensioni dhe përçarjeje. Veprimet i tilla interpretohen si një përpjekje për të manipuluar perceptimin e votuesve, duke krijuar një lidhje negative mes një partie politike dhe një figure politike të përfolur. Kjo mund të shihet si një mënyrë për të përdorur gjuhë fyese e degraduese për të stigmatizuar një subjekt politik dhe për të rritur ndjenjat negative kundrejt tij. Paneli vlerëson se partitë dhe kandidatët dhe simpatizantët janë të detyruar të respektojnë etikën zgjedhore dhe të shmangin veprime që mund të sjellin pasiguri apo të përkeqësojnë atmosferën politike. Përdorimi i figurave të tilla të përfolura mund të dëmtojë procesin demokratik dhe të rrisë tensionet në vend. Kjo është një shkelje e rregullave që kërkojnë një fushatë paqësore, të ndershme dhe të drejtpërdrejtë.

Përdorimi i një gjuhe të tillë, sipas vlerësimit të Panelit është në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11, e LZP-së, në të cilin përcaktohet se *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: ... 1) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”*.

Ky përfundim ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Me nenin 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, është përcaktuar se në rast se PZAP përcakton se ka ndodhur shkelje e të këtij ligji ose e rregullave të KQZ-së, mundet *“të vendosë një gjobë ndaj një subjekti politik, në vlerë deri në pesëdhjetëmijë (50,000 €) Euro.”*

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përben përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo ngjashëm, subjektit politik që ka bërë shkelje të legjislacionit zgjedhor, apo ka bërë shkelje të legjislacionit edhe në proceset e mëparshme zgjedhore, që konsiston në faktin se subjekti politik LVV, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje, dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë, që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore.

Andaj Paneli vëren se gjuha e përdorur nga mbështetësit e LVV-së, janë në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, përkatësisht, me dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të LZP-së, ku janë të përcaktuar veprimet e ndaluara të subjekteve politike.

Paneli me rastin e shqiptimit të gjobës ka pasur parasysh edhe praktikën e mëhershme për rastet të ngjashme si dhe faktin që subjekti politikë në fjalë, përkatësisht, mbështetësit e saj kanë bërë shkelje të natyrës së njëjtë, e për të cilat shkelje paneli ka shqiptuar dënime me gjobë.

Paneli ka vlerësuar edhe pretendimet nga përgjigja në ankesë, mirëpo të njëjtat i vlerësoi si të pa bazuara, për faktin se subjekti politik LVV të njëjtat pretendime nuk i ka provuar me asnjë provë të vetme.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11, neni 118 paragraf 1 lidhur me nenin 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

A.nr.352/2025 datë;06.02.2025

Kryesues i Panelit,
Hajriz Hoti



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimet të këtij vendimi.